

URDHËR
Nr. 4831, datë 31.12.2019

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të nenit 28, germa “d”, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;

Në funksion të mbarëvajtjes të veprimtarisë administrative dhe të zbatimit të detyrimeve të parashikuara në kuadrin ligjor në fuqi,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës për të trajtuar dhe për të nënshkruar shkresat informuese, sipas fushës përkatëse të përgjegjësisë, drejtorëve të njësive në Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK-së, si vijon:

- drejtorit të Njesisë së Titujve të Pronësisë, z. Enis Hoxha;
- drejtorit të Njesisë së Kadastrës dhe Hartografisë, z. Andi Proko;
- drejtorit të Njesisë Juridike dhe të Kontrollit, znj. Jeta Velaj;
- drejtorit të Njesisë së Financës, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, znj. Brikena Dervishaj.

2. Shkresat informuese të Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK-së, që u drejtohen të tretëve (persona fizikë, persona juridikë privatë dhe publikë) dhe trajtojnë kërkesë-ankesat e tyre, si dhe ato drejtuar strukturave të varësisë së ASHK-së, në funksion të kërkesë-ankesave, të nënshkruhen nga drejtorët e njësive të përmendura në pikën 1 të këtij urdhri, me përjashtim të ankimeve administrative që janë kompetencë e strukturës së posaçme për ankimet, sipas ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”.

Përjashtimisht, shkresat që u drejtohen Presidentit të Republikës, Kuvendit, Kryeministrit, ministrave, sekretarëve të përgjithshëm të ministrave, Prefektit, si dhe kryetarëve të bashkive, nënshkruhen nga drejtori i përgjithshëm.

3. Delegimi i kompetencës, sipas këtij urdhri, nuk përfshin aktet administrative dhe detyrat, të cilat duhet të miratohen dhe të ushtrohen, nga drejtori i përgjithshëm në zbatim të nenit 9, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”.

4. Pavarësisht delegimit të kompetencave sipas këtij urdhri, drejtorët e njësive, nëse e gjejnë të nevojshme, mund t’i përcjellin për miratim drejtorit të përgjithshëm shkresat që i vlerësojnë të rëndësishme të veçantë.

5. Në rast mungese në detyrë të subjekteve të përmendura në pikën 1 të këtij urdhri, delegimi i kompetencës konsiderohet i ndërprerë për periudhën e mungesës, në kuptim të nenit 29, pika 2, germa “ç” të Kodit të Procedurave Administrative. Gjatë mungesës, kompetenca ushtrohet nga Drejtori i Përgjithshëm i ASHK-së.

6. Ngarkohen njësitë dhe drejtuesit e tyre të përmendur në pikën 1 dhe Sektori i Arkivit dhe i Protokollit, në Drejtorinë e Përgjithshme, për zbatimin e këtij urdhri.

7. Urdhri nr. 987, datë 24.5.2019 i drejtorit të përgjithshëm të ASHK-së, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Artan Lame